



## **Të dashur studentë, pedagogë dhe praktikues,**

Projekti F.R.I.D.A.S. aktualisht po lançon raste të jetës reale të të drejtave të njeriut në punën sociale - të disponueshme falas për këdo që dëshiron t'i përdorë ato.

Në këtë buletin të dytë, do t'ju tregojmë për etapat më të rëndësishme dhe do t'ju japim një vështrim të shpejtë të punës së ardhshme të projektit F.R.I.D.A.S.

**Nëse projekti F.R.I.D.A.S. është diçka e re për ju:** F.R.I.D.A.S. është një projekt ndërkombëtar inovativ, i bashkëfinancuar nga Programi Erasmus+ (KA2 Partneritete Bashkëpunimi në Arsimin e Lartë), që forcon zbatimin praktik të të drejtave të njeriut në edukimin dhe praktikën e punës sociale. Ai bashkon katër universitete evropiane dhe një OJQ italiane për të promovuar vlerat e BE-së të barazisë, përfshirjes, mosdiskriminimit, pjesëmarrjes demokratike dhe metodave inovative të mësimdhënies. Periudha e projektit: 2024-2027.

*Në këtë buletin, do të lexoni rreth Përmbledhjes së rasteve studimore, takimit të partnerëve në Shqipëri, Kornizës së kompetencave dhe moduleve mësimore, si dhe punës sonë të ardhshme: Avokimi dhe fushatat si dhe një Komunitet virtual.*

Shpresojmë të frymëzojmë, inkurajojmë dhe mbështesim studentët e punës sociale dhe punonjësit socialë që t'i vendosin të drejtat e njeriut në thelb të praktikës së tyre dhe të avokojnë për shërbime sociale gjithëpërfshirëse, demokratike dhe të bazuara në të drejta.



Andrea Bilotti  
Koordinator i projektit  
fridas@uniroma3.it

# Lançimi i skedave të rasteve studimore F.R.I.D.A.S.

Projekti F.R.I.D.A.S. ka kënaqësinë të prezantojë një përmbledhje prej **46 skeda rastesh studimore** që paraqesin situata nga jeta reale në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut, diskriminimin dhe përfshirjen sociale. Çdo rast paraqitet në një format skede didaktike e aksesueshme dhe është gjithashtu i disponueshëm në një version audio shoqërues, duke i bërë materialet fleksibile dhe të lehta për t'u përdorur si në kontekstin e mësimdhënies ashtu edhe në atë të trajnimit.

Rastet u zhvilluan nga partnerët e projektit bazuar në intervista dhe grupe të fokusuara me punonjës socialë në **Shqipëri, Norvegji, Itali dhe Spanjë**. Duke u mbështetur drejtpërdrejt në praktikën profesionale, ato u ofrojnë studentëve dhe praktikuesve të punës sociale një grup të kuruar situatash autentike që nxjerrin në pah realitetet komplekse që hasen në punën sociale të përditshme.

Përmes këtyre rasteve, përdoruesit mund të eksplorojnë se si adresimi i nevojave të individëve vulnerabël është i lidhur ngushtë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Përmbledhja mbështet studentët në forcimin e të kuptuarit nga ana e tyre e rolit që luajnë të drejtat e njeriut në avancimin e përfshirjes dhe parandalimin e diskriminimit.

Të hartuara si një mjet mësimor dhe reflektimi, skedat e rasteve studimore inkurajojnë të menduarit kritik dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të rrënjosura në një **qasje ndaj punës sociale të bazuar në të drejtat e njeriut**.

Materialet ndihmojnë në nxitjen e aftësive kryesore transversale si empatia, të menduarit lateral dhe analiza reflektive, ndërkohë që rrisin gjithashtu aftësinë e studentëve për të identifikuar, parandaluar dhe reaguuar ndaj diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Fushat e përdorimit të përmbledhjes shtrihen nga mjedisi akademik në mjedise të tjera arsimore dhe profesionale, ku njohuritë mbi të drejtat e njeriut janë thelbësore për të nxitur një ndërgjegjësim kolektiv dhe përgjegjësi sociale më të madhe.

Skedat duhet të përdoren së bashku me udhëzuesin e përdorimit, dhe përzgjedhja e skedave bëhet e thjeshtë nga një shtojcë bashkëngjitur e cila ofron një pasqyrë të përmbajtjes kryesore për secilin rast.

Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

2024-1-IT02-KA220-HED-000251953

### NJË VAJZË ADOLESHENTE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PRIVOHET NGA SHËRBIMET SOCIALE

**SUBJEKTET E PËRFSHIRA**

Një vajzë 16-vjeçare me aftësi të kufizuara, e privuar nga shërbimet socio-edukative për shkak të mungesës së transportit publik (minibus).

**FAKTE**

Kjo bashki karakterizohet nga një popullsi e shpërndarë në zona të ndryshme rurale larg qendrës urbane. Shërbimet ofrohen vetëm në qendrin komunal, ndërsa banorët janë të shpërndarë në të gjithë rajonin.

Vajza 16-vjeçare, e cila ka lëvizshmëri të kufizuar dhe aftësi të kufizuara intelektuale të lehta, ka nevojë për infrastrukturë të veçantë dhe transport publik të përshtatshëm për të aksesuar shërbimet e përditshme socio-edukative. Qendra e vetme sociale për personat me aftësi të kufizuara ndodhet në zonën qendrore urbane, ndërsa ajo dhe familja e saj jetojnë në një vend të largët. Kjo krijon një sfidë të përditshme për prindërit e saj, të cilët shpesh nuk mund të gjejnë transport për të, duke rezultuar në mungesën e shërbimeve socio-edukative dhe izolimin e saj në shtëpi.

**PERIUDHA DHE KOHËZGJATJA**

2017–2025

Si një produkt qendror i projektit F.R.I.D.A.S., përmbledhja e rasteve studimore fton gjithashtu një reflektim më të gjerë mbi rolin e punës sociale. Në vend që të përqendrohen vetëm në nevojat individuale, rastet e vendosin praktikën e punës sociale brenda kontekstit më të gjerë të **të drejtave të njeriut, demokracisë dhe drejtësisë sociale**. Duke theksuar ndërhyrjet e punës sociale si përgjigje ndaj sfidave të të drejtave të njeriut - veçanërisht në fushën e të drejtave sociale - materialet theksojnë rolin thelbësor që luajnë punonjësit socialë në mbrojtjen e të drejtave themelore dhe promovimin e shoqërive gjithëpërfshirëse.

Rastet dhe materialet përkatëse i gjeni këtu (në pesë gjuhë): [Collection of case studies \(WP2\)](#)

## Testimi dhe vlerësimi i përmbledhjes së rasteve

Përmbledhja e rasteve u testua nga të gjithë partnerët akademikë për të vlerësuar përdorshmërinë, vlerën edukative dhe efektivitetin e saj në promovimin e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut në punën sociale. Në total 178 pjesëmarrës - duke përfshirë punonjës socialë, studentë, pedagogë, punonjës të rinj dhe edukatorë - morën pjesë në testim.

Pjesëmarrësit theksuan, ndër aspekte të tjera, se puna me rastet bëhet më kuptimplote kur ata e dinë se ato bazohen në njerëz dhe ngjarje të vërteta, pasi kjo e bën më të lehtë lidhjen dhe empatinë me njerëzit e përfshirë. Siç tha një nga punonjësit socialë nga Shqipëria: *Skedat janë të vërteta, jo si ato rastet e shpikura që kishim si studentë.*



*Foto: pesë studentë italianë që lexojnë raste në një seancë testimi*

Reagimet ishin përgjithësisht pozitive, duke theksuar potencialin e fortë edukativ të skedave dhe dobinë e tyre si një mjet praktik mësimor. Bazuar në rekomandimet e pjesëmarrësve, partneriteti rishikoi paraqitjen e skedave, përmirësoi gjuhën dhe zhvilloi

udhëzime për të mbështetur pedagogët, moderatorët dhe edukatorët në përdorimin efektiv të përmbledhjes.

Të gjitha raportet janë të disponueshme në këtë link: [Testing and evaluation of the cards](#)

## Takimi i partnerëve në Shqipëri, 2-3 tetor 2025

Konsorciumi F.R.I.D.A.S. u mbledh në Shkodër, Shqipëri, për një takim koordinues dyditor të organizuar nga partneri ynë shqiptar, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Takimi mbledhi partnerë të projektit nga Norvegjia, Italia, Spanja dhe Shqipëria për të shqyrtuar progresin e projektit, për të shkëmbyer përvoja dhe për të diskutuar hapat e mëtejshëm të projektit F.R.I.D.A.S.

Gjatë gjithë takimit, partnerët ndanë gjetjet fillestare nga faza e testimit të skedave të rasteve edukative, eksploruan përdorimin edukativ të rasteve studimore dhe reflektuan mbi mënyrat se si punonjësit socialë mund të mbështesin dhe zbatojnë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut si në mjediset akademike ashtu edhe në ato profesionale.

Axhenda përfshinte gjithashtu një përmbledhje të arritjeve gjatë vitit të parë të projektit dhe prezantimin e udhëzimeve të zbatimit të WP3. Këto udhëzime përqendrohen në zhvillimin e një kuadri kompetencash dhe module të të nxënit që synojnë forcimin e edukimit për të drejtat e njeriut brenda shkollimit në punën sociale.

Takimi ofroi një mundësi të rëndësishme për bashkëpunim dhe shkëmbim njohurish midis partnerëve, duke përforcuar angazhimin e përbashkët të konsorciumit për të integruar të drejtat themelore në praktikën dhe trajnimin e përditshëm të punonjësve socialë.



Foto: një foto e partnerëve

## Korniza e kompetencave dhe modulet e mësimdhënies

Konsorciumi F.R.I.D.A.S. po punon aktualisht për zhvillimin e një Kornize kompetencash për të Drejtat e njeriut në edukimin në punën sociale. Kjo kornizë do të mbështesë universitetet në forcimin e integritit të parimeve të të drejtave të njeriut brenda

kurrikulave dhe programeve ekzistuese të trajnimit në punën sociale. Në veçanti, korniza synon të sigurojë që punonjësit e ardhshëm socialë të fitojnë jo vetëm njohuri teorike për të drejtat e njeriut, por edhe ndërgjegjësimin dhe aftësitë praktike të nevojshme për të zbatuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut në praktikën e përditshme profesionale. Kjo qasje është në përputhje me kodet ekzistuese profesionale të etikës si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë evropian, duke përforcuar themelet etike të punës sociale.

Korniza e kompetencave është strukturuar rreth pesë fushave kryesore të të nxënit:

1. **Njohuritë mbi të drejtat e njeriut dhe Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian** – forcimi i të kuptuarit të studentëve për të drejtat themelore dhe rëndësinë e tyre për praktikën e punës sociale, duke përfshirë Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian.
2. **Etika dhe qasjet e bazuara në të drejtat e njeriut në punën sociale** – shqyrtimi i përgjegjësiive etike të punonjësve socialë dhe se si parimet e të drejtave të njeriut mund të udhëheqin vendimmarrjen profesionale.
3. **Nga stereotipet te racizmi i padukshëm** – të ndihmuarit e studentëve që të njohin stereotipet, paragjykimet e fshehura dhe format strukturore të diskriminimit që mund të prekin individët vulnerabël.
4. **Ndërsektorialiteti dhe ndjeshmëria ndërkulturore** – zhvillimi i vetëdijes se si identitetet sociale të mbivendosura dhe pabarazitë ndikojnë në përvojat e njerëzve dhe aksesin në të drejta.
5. **Komunikimi jo i dhunshëm** – promovimi i aftësive të komunikimit me respekt, empatik dhe konstruktiv të cilat mbështesin praktikën profesionale gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në të drejta.



## Modulet mësimore

Duke u bazuar në Kornizën e kompetencave për të drejtat e njeriut, konsorciumi F.R.I.D.A.S. po zhvillon një grup prej gjashtë modulesh mësimdhënieje online të hartuara për studentët e punës sociale. Modulet do të ofrohen përmes platformës së e-learning të projektit (Moodle, e organizuar nga Universiteti i Romës Tre) dhe do t'u ofrojnë

studentëve mjete praktike për të zbatuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut në edukimin dhe praktikën e punës sociale.

Kursi përfshin një modul hyrës që prezanton projektin F.R.I.D.A.S., i ndjekur nga pesë module tematike që pasqyrojnë fushat kryesore të të nxënit të kornizës së kompetencave: të drejtat e njeriut dhe Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian; etika dhe qasjet e bazuara në të drejtat e njeriut në punën sociale; stereotipet, paragjykimet dhe racizmi i padukshëm; ndërsektorialiteti dhe ndjeshmëria ndërkulturore; komunikimi jo i dhunshëm. Çdo modul është zhvilluar nga njëri prej partnerëve të projektit dhe është hartuar si një njësi mësimore e cila ndërthur përmbajtjen teorike me burime multimediale, të tilla si lexime, toolkit-e dhe video të shkurtra.

Për të mbështetur të nxënit aktiv, çdo modul përfshin rezultate të të nxënit të përcaktuara qartë, materiale mësimore të kuruara dhe një test të shkurtër vetëvlerësimi që u lejon studentëve të reflektojnë mbi kompetencat e fituara. Pas përfundimit, pjesëmarrësit do të marrin një certifikatë virtuale. Modulet do të jenë të disponueshme në anglisht dhe në gjuhët kombëtare të partnerëve, duke siguruar akses për studentët në të gjitha vendet pjesëmarrëse.

Në fazën tjetër të projektit, kursi online do të testohet me studentë dhe profesorë nga universitetet partnere. Reagimet e tyre do të mbështesin përmirësimin dhe validimin e paketës së trajnimit përpara se ajo të vihet në dispozicion të publikut.

---

## Së shpejti: Avokimi dhe fushatat, si dhe një komunitet virtual



*Faza tjetër e projektit e zhvendos fokusin nga ndërhyrja individuale në transformimin kolektiv shoqëror.*

- **Komuniteti virtual:** Kjo do të jetë një hapësirë dixhitale transnacionale për të nxënit nga kolegët dhe për bashkëkrijimin e njohurive. Është projektuar si një mjedis mësimor i vazhdueshëm ku identiteti profesional formësohet përmes ndërveprimit dhe shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare.
- **Avokimi dhe fushatat: po zhvillojmë 6 "video pilula" edukative** - nxitës të shkurtër dhe dinamikë të menduar për të aktivizuar debatin. Këto video, të prodhuara nga partnerët në Itali, Spanjë, Norvegji dhe Shqipëri, do të ofrojnë strategji specifike për avokim social dhe mjete për hartimin e fushatave ndërgjegjësuese me ndikim.
- **Veprim bashkëpunues:** Brenda komunitetit virtual, këto burime video do të shërbejnë si katalizatorë për diskutime të moderuara dhe aktivitete bashkëpunuese, duke çuar në zbatimin e një fushate avokimi në botën reale që synon të ndikojë në politikat publike dhe diskursin shoqëror.

---

## Partneriteti

Partneriteti përbëhet nga katër institucione të arsimit të lartë të nivelit terciar dhe një organizatë jofitimprurëse nga Italia, Spanja, Shqipëria dhe Norvegjia, duke kombinuar ekspertizë të shëndoshë në edukimin për të drejtat e njeriut, ndërhyrjen profesionale ndërdisiplinore në punën sociale dhe zhvillimin komunitar.



UNIVERSIDAD  
DE GRANADA



### Partneri Koordinues:

Universiteti i Romës Tre, Departamenti i Edukimit

### Partnerët:

Universiteti i Granadës, Departmenti i Punës sociale dhe Shërbimeve sociale

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Departmenti i Psikologjisë dhe Punës sociale

Universiteti Norvegjez i Shkencës dhe Teknologjisë, NTNU, Departmenti i Punës sociale

RE.DU Rrjeti i Edukimit i të Drejtave të Njeriut

---

## Na kontaktoni dhe qëndroni të përditësuar

Për çdo pyetje ose për të kontribuar në projektin tonë me përvojën tuaj në veten e parë, na kontaktoni në email:

[fridas@uniroma3.it](mailto:fridas@uniroma3.it)

Mezi presim t'ju mbajmë të informuar mbi progresin dhe rezultatet tona.

Faleminderit për interesin dhe mbështetjen tuaj!



### Na ndiqni në:



[Facebook](#)



[LinkedIn](#)



[Instagram](#)



[www.thefridasproject.eu](http://www.thefridasproject.eu)



**Bashkëfinancuar nga  
Bashkimi Evropian**

2024-1-IT02-KA220-HED-000251953

*Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.*